



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 06.07. 2017

Me mbështetjen e Projektit, Oda e administratorëve të falimentimit shënoi përvjetorin e dhjetë

Pa kompromise drejt ristrukturimit, për shpëtim të ardhmërisë së kompanive

Fakti që 200,000 kompani në vit falimentojnë në vendet e Bashkimit Evropian dhe 1.7 milionë punonjës mbeten pa punë, është një arsye më shumë për direktivat e miratuara për ristrukturimin e kompanive dhe për ruajtjen e të ardhmes së tyre afariste. Udhëzimet Evropiane për rehabilitim dhe ristrukturim, sipas presidentit të Odës së administratorëve të falimentimit Aco Petrov, paraqesin një thirrje për angazhim aktiv në atë drejtim

Oda e Administratorëve të Falimentimit të Republikës së Maqedonisë shënoi përvjetorin - 10 vite nga themelimi i saj. Me këtë rast, më 6 korrik në hotelin "Holiday Inn", vendi ku u themelua Oda dhjetë vjet më parë, u mbajt një akademi solemne. Para mysafirëve të pranishëm fjalimet e tyre i mbajtën kryetari i Odës së administratorëve të falimentimit të Republikës së Maqedonisë Aco Petrov, Zëvendësministri i Ekonomisë Kire Naumov, përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së në Maqedoni, Jaromir Leviček dhe udhëheqësi i ekipit të projektit për përforcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të kompanive tregtare, Krasin Dimitrov.



Në fjalimin e tij kryetari i Odës së administratorëve të falimentimit Aco Petrov theksoi se ndryshimet dinamike krijojnë hapësirë edhe për drejtime të reja në aktivitetet e Odës. Me zgjidhjet më të mira, të ngulitura në praktikat e mira evropiane, me mekanizma më të mirë të kontrollit, do të dëshironim edhe ndryshim gradual në botëkuptimet sipas të cilave falimentimi vetvetiu shihet si falimentim, theksoi Petrov. Do të mirëpresim ndryshime në rregullativën ligjore e cila do të krijojë supozimet që falimentimi të jetë i shpejtë dhe efikas, dhe paralelisht me të edhe paralajmërimi i hershëm, rinovimi dhe riorganizimi të paraqesin mundësi për veprim parandalues edhe të kompanive tek ne. Direktivat e miratuara në këtë fushë, sipas Petrov, dhe sidomos ajo që lidhet me rehabilitimin dhe ristrukturimin, paraqet një thirrje për angazhim aktiv në këtë drejtim. Direktivat japin udhëzime rreth nevojës për përforsimin e vazhdueshëm, gjithëpërfshirës si të organeve për falimentimin, ashtu edhe të debitorëve dhe kreditorëve për sa u përket njohurive, kapacitetit dhe të kuptuarit e përgjithshëm të tyre mbi falimentimin.



Përmes Projektit që po realizojmë në Ministrinë e Ekonomisë, për përforsimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim, kemi realizuar bashkëpunim me Odën e administratorëve të falimentimit në disa segmente, theksoi udhëheqësi i ekipit të projektit, Krasin Dimitrov. Administratorët e falimentimit kanë marrë pjesë në konsultimet për aspektet normative dhe parimet bazë të procedurës së falimentimit, dhe pastaj edhe në debatet në tryezat e rrumbullakëta, ku përmes shembujve konkret nga praktika, është analizuar zbatimi i legjislacionit ekzistues. Për më tepër, këtë vjeshtë, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë, dhe për nevojat e Odës do të realizojmë dy trajnime, nga të cilat presim interesim më të madh tek të rinjtë për profesionin e administratorit të falimentimit, ndërsa administratorët ekzistues të zgjerojnë njohuritë e tyre me trajnimin e specializuar për ristrukturimin e kompanive.

Duke përshëndetur anëtarët e Odës, dhe duke i përgëzuar për përvjetorin, Zëvendësministri i Ekonomisë, Kire Naumov, dëshiroi bashkëpunim të mëtejshëm të suksesshëm me Ministrinë e Ekonomisë, i cili rrjedh nga legjislacioni ekzistues. Sipas Naumov, harmonizimi me legjislacionin evropian kërkon zgjerim të vazhdueshëm të njohurive të administratorëve të falimentimit për përmirësime në punën e tyre. Të dhënat aktuale flasin për rreth 1.000 procedime aktive të falimentimit, ndërsa 8.000 kompani janë duke u kontrolluar në DAP, dhe varësisht nga situata e konstatuar, pritet që për një pjesë të mirë të tyre të propozohet hapja e falimentimit. Sipas Naumov, kjo sasi e punës paraqet një sfidë serioze për 56 administratorët e licencuar të falimentimit. Prandaj, Ministria e Ekonomisë, me kërkesë të Odës, përcaktoi dy trajnime që do të realizohen këtë vjeshtë dhe nga të cilat pritet që për profesionin e administratorit të falimentimit të interesohen të rinjtë. Në

të njëjtën kohë, kjo paraqet një mundësi që edhe administratorët ekzistues të falimentimit të zgjerojnë njohuritë e tyre me trajnime të specializuara për ristrukturimin e kompanive.



Duke theksuar nevojën për ristrukturimin e firmave insolvente, përfaqësuesi i delegacionit të BE-së në Maqedoni, Yaromir Leviček, theksoi se sipas të dhënave të paraqitura para dy vitesh nga Vëra JOUROVÁ, Komisioneri i BE-së për Drejtësi, Konsumatorë dhe Barazi Gjinore, 200,000 firma falimentojnë për çdo vit - kjo është 600 në ditë! duke rezultuar në një humbje të drejtpërdrejtë prej 1.7 milion vendeve të punës çdo vit. Rreth një e katërta e këtyre falimentimeve kanë të bëjnë me bizneset që veprojnë përtej kufijve.



Leviçek theksoi se me numra kaq dekurajues, BE-ja po përpiqet të modernizojë kornizën ligjore për insolvencë. Qasja e re fokusohet në ristrukturimin e firmave dhe jo në likuidimin e tyre. Kjo qasje u jep gjithashtu bizneseve dhe punonjësve të tyre mundësinë për të shpëtuar dhe për të rihyrë në ekonominë produktive atëherë kur kanë vështirësi financiare. Bizneset do të shpëtohen, dhe sipërmarrësit dhe konsumatorët do të fitojnë një shans të dytë.

Me rastin e përvjetorit të 10, si shprehje e mirënjohjes për kontributin në krijimin, zhvillimin dhe mbështetjen e veprimtarisë, anëtarët e Odës, si dhe institucionet me të cilat kanë bashkëpunuar, morën certifikata mirënjohjeje.